

JOLANDA LILA

**KOMUNIKIMI I LETËRSISË SË EKZILIT ME SISTEMIN LETRAR
KOMBËTAR: RASTI I MARTIN CAMAJT**

821.18.09

Abstrakti: Poetika e Martin Camajt përbën një nga modelet përfaqësuese të nënsistemit letrar të ekzilit, që solli komponente gjenuine në sistemin letrar kombëtar. Pozicion i letërsisë së shkruar prej tij është jashtëqendror ndaj gjithë sistemeve të letërsisë shqipe, duke përfshirë dhe letërsinë e shkruar prej mërgimtarëve; dhe njëherësh po aq jashtëqendrore dhe ndaj makrosistemeve të letërsive të mëdha evropiane bashkëkohore, me të cilat u lidh vetëm përmes përkthimeve.

Gjithçka që shkroi në krijimtari, ai ia drejtoi lexuesit shqiptar si lexues i parë, pavarësisht se e dinte mirë se pikërisht ky ishte lexuesi i ndaluar dhe i munguar i veprës së tij. Në mënyrë të vetëdijshme ai provoi të krijonte qendrën e vet, origjinale dhe të papërsëritshme, në shqetësimet letrare, në tematikë, në përvojën estetike krijuese dhe në rendin gjuhësor.

Kjo kumesë do të nxjerrë në pah marrëdhënien autor-receptues në rastin e Camajt, duke e parë në dy plane: së pari, në planin e mungesës së komunikimit me lexuesit shqiptar për shumë vite, pasi vepra e tij u ndalua në Shqipëri (por u penguan edhe në Kosovë e diasporë) dhe së dyti, në planin estetik, vepra moderne e Camajt komunikon më shumë me vetveten sesa me lexuesin masiv. Ekskomunikimi duket sikur e përndjek ngahera këtë autor: fillimisht ai historiko-politik e më pas estetik-receptues. Përmes trajtësimit të tipareve të komunikimit të veprës së Camajt, do të kalohet edhe në përgjithësime për vështirësitë e funksionimit të hallkës autor-vepër-lexues në rastin e letërsisë së ekzilit në përgjithësi.

Fjalët kyçe: letërsi ekzili, lexues, poetikë, modernitet, censurë

Abstract: Communication of the exile's literature with national literary system: the case of Martin Camaj
Poetics of Martin Camaj constitutes one of the main models of literary subsystem of the exile that bring forward genuine elements in the Albanian literature.

The position of his poetical structure is eccentric to all Albanian literature system, including literature of migrants, and simultaneously as an equally eccentric to macrosystem of major European contemporary literatures, with which connected through translation of different books.

Everything that he wrote in books was dedicated to the Albanian readers, as the first reader, although it knew very well that this was the missing and prohibited reader of his own books. He consciously tried to create its own center, original and unrepeatable, in literary concerns, thematic, aesthetic experience and linguistic order.

The main purpose of this paper is to bring forward the relationship of author-reader in the case of Camaj, to see in two directions: on the one hand, in the plan of absence of communication with Albanian readers for many years, because his books were banned in Albania and on the other hand, in the aesthetic plan, the modern style of Martin Camaj communicate with itself more than with massive readers. Non-communication seems to be a permanent aspect for this author. The process of the communication analysis in the case of Camaj will generalize the difficulties of the relationship author-book-reader in case of the exile's literature in general.

Key word: Exile's literature, reader, poetics, modernity, censorship

Moskomunikimi me horizontin pritës

Në kontekstin e zhvillimit të poezisë shqipe bashkëkohore, marrëdhënia autor-receptues në rastin e Camajt është krejt e veçantë, për dy arsye: *së pari*, në planin e drejtpërdrejtë, poezia dhe krijimtaria e tij letrare në tërësi ishte pa lexues deri në muzg të jetës së autorit dhe kuptohet se procesi i të shkruarit pa procesin e njëkohshëm të receptimit krijon një sistem të paplotë funksionues për veprën letrare^{1*}. Mospasjen e horizontit pritës ose të lexuesit si destinatar të natyrshëm të artit poetik, poeti dhe studiuesi Primo Shllaku, e sheh si shkaktues të "nji konstipacioni të hatashëm tek autori, nji gjendje gjysmë patologjike tejet të bezdisshme, ku librat e palexuem ose të pambriritun në destinacion u përngjasin placentave që hallakaten mes shalësh mbas një lindje të paplotë. Kjo gjendje dëshpërimi kulturor e rrit përbind prirjen për krizë shpirtnore deri sa me e konsiderue krijimin tand nji send të pakuptim e të kotë."² Konstatimi i Primo Shllakut rrjedh prej dejeve të krijuesit, i cili është plotësisht i vetëdijshëm për tragjizmin e brendshëm të poetit kur vepra e tij nuk lexohet e nuk vlerësohet, sidomos pas përpjekjeve titanike për përsosmërinë estetike.

Sipas studiuesit Bashkim Kuçuku, vetë Martin Camaj në letërkëmbimet me miqtë e tij ka shprehur shqetësimin për ndalimin e veprës së vet në Shqipëri dhe pengimin e saj në Kosovë e në diasporë. Pas botimit të romanit "Rrathë" dhe vëllimit poetik "Njeriu me vete e me të tjerë" në vitin 1978, e sidomos në vitin 1979, ka nisur procesi censurues dhe refuzues i veprës së tij edhe në Kosovë. Në një letër të drejtuar mikut të vet të arratisë At Daniel Gjeçajt, më 6 shkurt 1982, Camaj shprehej: *"Jam ngusht për punën e librave letrarë të mij, në çdo pikëpamje... kjo botë këtu dhe atje në vend qenka fort e kapërthyme dhe e lidhin me tetëqind tejsa të papashëm! Prej të katër anëve ka fillue nji sabotim, që mos të shpërndahen këta libra as në diasporë, as në Kosovë e në Shqipni jo që jo! Më kanë bllokue krejtësisht."*³ Absurdi i prapësimit të veprave të tij në Shqipëri e Kosovë ishte tematikë mbizotëruese në epistolarin e këtij krijuesi.

Zinxhiri i komunikimit autor-vepër-lexues në këtë rast paraqitet i gjymtuar, sepse funksionon vetëm njëra hallkë, pra raporti i krijuesit me veprën e vet, ndërsa hallka tjetër mbetet thjesht imagjinare. Mosfunksionimi i hallkës së dytë e bën veprën një produkt stok, që shumohet vetëm për vetveten dhe nuk konsumohet nga askush. Megjithatë, Martin Camaj nuk është zbrapsur e as dekurajuar nga ky çbalancim polarizues mes punës krijuese dhe asaj receptuese, por përkundrazi deri në fund të jetës nuk ka reshtur së shkruari, duke u ngjitur gjithnjë e më lart në kurbën e vlerave estetike (kjo dëshmohet me veprën "Palimpsest", që i përket fazës së fundit krijuese).

^{1*} Poezia e Martin Camajt është bërë e njohur për lexuesit shqiptarë pas viteve '90. Dalja prej sistemit totalitar dhe hapja e Shqipërisë me botën krijoi mundësinë për njohjen e bashkëkombasve që endeshin nëpër vende të ndryshme. Një prej këtyre bashkëkombasve ishte Martin Camaj, i cili jo vetëm e kishte ruajtur me fanatizëm gjuhën autoktone dhe kulturën dhease, por ishte përfshirë më tej në procesin humlues ndaj tyre, duke i veshur edhe me përvojën erudite të mësimeve të marra në Romë e Mynih.

Në Shqipërinë shtetërore emri i Martin Camajt do të çmjegullohej shumë vonë. Për herë të parë ai është përmendur në vitin 1990, kur doli nga shtypi libri "Vepra e Bogdanit" i Ibrahim Rugovës. Emri i Martin Camajt, ndryshe prej "Studimeve etimologjike në fushë të shqipes" të Eqrem Çabejt, në librin e I. Rugovës nuk u hoq prej sistemit të referencave dhe as prej bibliografisë themelore. Më 15 qershor 1991, në gazetën "Zëri i rinisë" u botuan vjershat e tij të para. E përjavshmja "Drita", zëdhënëse e Lidhjes së Shkrimtarëve, botoi për herë të parë krijimtari të Camajt në numrin e datës 20 tetor 1991. (Bazuar në të dhënat e studimit monografik: "Camaj i paskajuar - Rreth tipologjisë së llojeve në veprën e Martin Camajt" të autorit Shaban Sinani, botim i Qendrës së Studimeve Albanologjike & Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Tiranë, 2011, shih për më tepër në f. 9 dhe f. 14). Referuar të dhënave bibliografike në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë rezulton se artikulli i parë i botuar në Tiranë për krijimtarinë letrare të Martin Camajt, është publikuar nga Fatmir Alimani, në gazetën Drita, më 24 mars 1991, me titullin *Martin Camaj - Madhështia e fjalës së lirë*. Në fund të jetës së tij, ai arriti të komunikonte me lexuesit shqiptarë dhe njëherësh të njihej me disa konsiderata e vlerësime për krijimtarinë e vet, të botuara në shtypin e kohës.

² Shllaku, Primo, *Nji Ullik që s'mbriri kurr në Itakë (Martin Camaj)*, Sh.b. At Gjergj Fishta, Lezhë, 2006, f. 143.

³ Kuçuku, Bashkim, "Letërkëmbimi i Camajt: si u ndaluan në Shqipëri dhe pengimi në Kosovë", gazeta "Panorama", 25 shtator 2010. Si dhe në gazetën "Standard", 25 shtator 2010, fq. 14-15.

Marrëdhënia e tij me lexuesit paraqitet tejet paradoksale, jo vetëm sepse kjo marrëdhënie ngrihej në dy hapësira të ndryshme kulturore dhe shoqërore, por edhe se raporti i dy hallkave autor-vepër dhe lexues-vepër kishte natyrë antagoniste. Si autori ashtu edhe lexuesit ishin nën kushtet e censurës dhe mohimit, por kjo pengesë ishte e formave të ndryshme. Nga njëra anë, autori i krijonte në liri të plotë veprat e veta, por prangat e censurës komuniste e pengonin depërtimin e tyre në horizontin pritës, që shestonte të arrinte autori. Nga ana tjetër, shqiptarëve iu mohua hapja me botën dhe mbi të gjitha leximi i veprave të ashtuquajtura disidente. Kjo panoramë e dy realiteteve të ndryshme ka në thelb të njëjtën pasojë, pikërisht moskomunikimin, ku shqiptarëve iu mohojë leximi i veprave të Camajt, ndërsa këtij të fundit i mohojë kthimi në botën e tij dhe depërtimi tek lexuesit e vet. Studiuesi dhe poeti Primo Shllaku e konsideron të plotë barazimin mes shqiptarëve dhe Camajt, kur thotë: "Nëse shqiptarët ishin njerëzit ma të izoluem të Europës, sepse nuk lejoheshin me dalë përjashta, Martin Camaj ishte intelektual i ma të izoluem i Jugosllavisë, Italisë e Gjermanisë, sepse nuk lejoheshin me ardh në shtëpinë e vet. Barazimi asht i plotë."¹ Censura komuniste nuk mundi të pengonte ngjizjen dhe konsolidimin e krijimeve poetike të autorit, por izoloi e ndaloi plotësisht qarkullimin e tyre, duke mohuar receptuesit, pra ata që i japin vlerë e jetë një vepre letrare.

Së dyti, në planin estetik, poezia moderne e Camajt komunikon më shumë me vetveten sesa me lexuesin masiv. Si ta kuptojmë këtë lloj moskomunikimi? Moskomunikimi do të vijojë ta përndjekë poezinë e tij edhe pas viteve '90, por tashmë jo më për arsye politike, po për arsye estetike. Lexuesi shqiptar i pamësuar me ligjërimin e poezisë moderne dhe me trajtat dialektore, leksikore dhe shumëkuptimore të gjuhës së këtij autori, vijon t'i qëndrojë larg procesit receptues të kësaj lënde poetike, ose më saktë të kësaj alterpoetike. Në sfondin e përgjithshëm të poezisë shqipe, mund të themi se përfaqëson më tepër një alterpoetikë, sigurisht nëse për poetikën pranojmë njërin prej tri kuptimeve të rëndësishme që na kumton ky term, sipas të cilit fakti letrar është "një formë e veçantë e gjuhës dhe kuptimësimit e jo rezultat i rrethanave shoqërore, psikologjike apo politike"².

Tiparet letrare të stilit të tij, larg automatizimit të gjuhës, e bëjnë poezinë e Camajt të qëndrojë ende në distancë me receptuesit, edhe pse vepra e tij prej më shumë se dy dekadash qarkullon lirisht në Shqipëri, edhe pse poezia e tij është pjesë e programeve shkollore, por edhe pse pas vitit 1996 vepra e tij u botua thuajse e plotë për lexuesit shqiptarë.

Procesi i komunikimit të poezisë me vetveten projekton lexuesin ideal dhe njëherësh, e shtrin komunikimin në pafundësi rrjetesh strukturore e ideore. Errësimi i shprehjes gjuhësore gjeneron shumëngjyrësi rrafshesh interpretuese dhe qasja subjektive për ligjet në cdo grimcë të tekstin poetik. Kjo formë hermetike e të komunikuarit mund të jetë rezultat i pavetëdëshëm i marrëdhënies reale inekzistente mes autorit e lexuesit, marrëdhie që buttohet edhe në planin estetik. Ngarendja drejt përsosmërisë së shprehjes poetike, fjalorit dhe strukturës poetike në përgjithësi, ia ka zbehur fuqinë pikëtakimeve konkrete me lexuesit, duke ndërtuar një marrëdhënie racionale e njëherësh paradoksale, sepse kuptimi i përfutur prej lexuesit vështirë të përputhet me atë të autorit. Për shkak të gjuhës ezoterike dhe shprehjes tejet moderne, poezie e tij është konsideruar si hermetike³, larg interpretimit të drejtpërdrejtë e njëdimensional dhe për pasojë, larg lexuesit masiv.

Ekskomunikimi duket sikur e përndjek ngahera këtë autor: fillimisht ai historiko-politik e më pas estetiko-receptues. "Pozicion i letërsisë së Camajt është jashtëqëndror ndaj gjithë sistemeve të letërsisë shqipe, duke përfshirë dhe letërsinë e shkruar prej mërgimtarëve; dhe njëherësh po aq jashtëqëndrore dhe

¹ Shllaku, Primo, *Nji Ullks që s'mbririti kurr në Itakë (Martin Camaj)*, Sh.b. At Gjergj Fishta, Lezhë, 2006, f. 194.

² Abercrombie, Lascelles. *The theory of poetry*, Biblo and Tannen, New York, 1968, f.47.

³ * Çështja e hermetizmit në poezinë e Camajt do të sqarohet në vijim të këtij kapitulli.

ndaj makrosistemeve të letërsive të mëdha evropiane bashkëkohore, me të cilat u lidh vetëm përmes përkthimeve: gjithçka që shkroi në krijimtari ai ia drejtoi lexuesit shqiptar si lexues i parë, pavarësisht se e dinte mirë se pikërisht ky ishte lexuesi i ndaluar dhe i munguar i veprës së tij. Në mënyrë të vetëdijshme ai provoi të krijonte qendrën e vet, origjinale dhe të papërsëritshme, në shqetësimet letrare, në tematikë, në përvojën estetike krijuese dhe në rendin gjuhësor."¹

¹ Sinani, Shaban, *Camaj i paskajuar (Rreth tipologjisë së llojeve në veprën e Martin Camajt)*, Qendra e Studimeve Albanologjike & Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2011, f. 153-154.

ARIAN LEKA

**TJETRI NË KRIJIMTARINË E SHKRIMTARIT JOVAN
NIKOLADIS DHE HETERONIMIA SIKRIJUESE E IDENTITETIT
VIRTUAL**

821(497)(049.3)

Tjetërsia dhe Tjetërsimi

Koncepti i “Tjetrit” në kulturën europiane është hulumtuar herët, duke u bërë objekt vëzhgimi që nga kohët klasike, kur “Tjetri” ishte *Barbaari* - kulturalisht i ndryshëm nga individi *Unë* dhe bashkësia *Ne*. Si të tillë, *barbarë*, përfillëshin popujt, kulturat dhe shoqëritë *e tjera / të huaja*, që nuk kishin të njëjtën kulturë me ata që i emërtuan ata dhe që nuk përdornin të njëjtin standard me jetesën e vendasve të tjerë / *jo-barbarë*.

Gjithë sa Greqinë antike nisi si një kundërvënie mes Veriut dhe Jugut dhe ndaj trakëve e skitëve, sot është shndërruar në eponim të ndarjes kulturore mes Lindjes (*Tjetri* - barbar, fisnor, i prapambetur, primitiv) dhe Perëndimit (*Ne* - të qytetëruarit).

Ky kod dikotomik shenjimi, që dikur ishte pranuar si normë për qytetërimin antik, e mbrojti thelbin e vet, duke mbërritur si i tillë edhe sot kurtermi hapsinor Lindje / Perëndim nuk përdoret më për të dalluar drejtimit në natyrë, por për të përkufizuar kulturën e një shoqërie që vendoset pranë apo larg boshtit të vlerave qytetëruese.

Në diskursin fenomenologjik, termi *Tjetri* shtjellohet si një *alter ego*, një *TjetërVetë* dhe si një pikëmbështetje për intersubjektivitetin¹. Kjo pikëpamje *Tjetrikrijon* marrëdhënien, keqkuptimin apo marrëveshjen mes nesh, duke na nxitur ta vështrojmë nocionin si mundësi për t’u vendosur në vendin ku *Tjetri* lindodhet dhe duke e sugjeruar *Tjetrin* si burim objektiviteti në vlerësim.

Ndërkohë, diskursi filozofik i referohet konceptit *Tjetri* si entitet homolog i përcaktimit të vetes dhe “tjetërsisë”, që e bëjnë të dallueshëm *Tjetrin* nga përfaqësimi simbolik i vetes.

Këtyre koncepteve, përkufizimit të *Vetes* dhe cilësimit të *Tjetrit* dhe sidomos marrëdhënies (ar)miqësore mes tyre, shkrimtari Jovan Nikolaidis i ka kushtuar vëmendje të posaçme prej më shumë se dy dhjetëvjeçarësh.

Ky zë i “modest, por i pathyeshëm”, siç vetëcilësohet, i ka shprehur idetë e tij përmes librave dhe artikujve të shumtë kushtuar temës së *Tjetrit*. Shkrimtari Jovan Nikolaidis ka krijuar një epistemë rreth termit, që në thelb do të thotë ta njohësh dhe ta kuptosh *Tjetrin*.

Duke filluar me shkrimet më të hershëm, te cilat janë botuar në mediat sociale për lexuesin e cilësuar, me të cilin autori ndërvepron në mënyrë të atypëratyshme dhe të drejtpërdrejtë dhe deri te libri më i fundit “Shqiptarët dhe unë”², publikuar për lexuesin anonim të librit tipografik, ky autor trajton konceptet *Tjetri*, *Tjetërsia* dhe *Tjetërsimi* si ambivalencë dhe si të rëndësishme për ndërtimin e identiteteve shoqërore.

¹ Edmund Husserl, *Cartesian Meditations: An Introduction to Phenomenology*. “Martinus Nijhoff Publishers”. The Hague, Netherlands, 1982. Fq. 42-62.

² Jovan Nikolaidis: *Shqiptarët dhe unë*. “Koha”, Prishtinë, 2018.

Një mendim i tillë ndjek nocionet e Zygmunt Bauman-it, që e shtjellon *Tjetërsinë* si thelbësore për krijimin e kategorive të identitetit. Sot jetojmë në periudhën kur duhet të pajtohemi me ambivalente, që krijojnë ndjesitë kundërta e të përziera ndaj atij objekti të përbashkët të cilin e cilësojmë *I huaj*.¹

Nga ana tjetër ky autor i kundërvihet epistemës, duke u ndarë nga “doxa” dhe duke u larguar nga stereotipet dhe mendimi i kolektiv ndaj *Tjetrit*, për t’i dhënë atij një rol të ri në përcaktimin e kufijve socialë e kulturorë.

Edhe në këtë rast metaforat Zygmunt Bauman-it rreth “brenda dhe jashtë kufirit” rimerren nga Jovan Nikolaidis si në rrafshin politik e social ashtu edhe në atë kulturor. Idetë tilla janë shprehur në libra të veçantë, siç janë plotësuar edhe përmes komunikimit të autorit me lexuesin virtual, duke filluar nga themelimi i shoqatës kulturore “Plima / Batica” në vitin 1996 e më vonë me revistën kulturore “Plima Plus”, që promovon multikulturalizmin, multilinguizmin dhe diversitetin kulturor, përmes pohimit të vlerave dhe kundërvënies ndaj ringjalljes së stereotipeve ndaj *Tjetrit*, të cilin priremi ta shtyjme drejt tjetërsimit.

Teksa shpreh pikëpamjet e tij mbi rendin simbolik të vendasit dhe të ardhurit, të tjetrit tonë, të minoriteve dhe të huajve, autoktonëve dhe aloktonëve, ky autor shkruan se vendin ku ai jeton nuk ka pakica apo shumica kulturore, nuk ka të Tjerë dhe se të gjithë çdo banor i Malit të Zi është shtetas malazez.²

Krahas këtij mendimi studiuesi kroat Goran Starcević³ veçon edhe një tjetër ide të Jovan Nikolaidisit, kur ky shkruan rreth marrëdhënieve historike të ballkanasve të djeshëm dhe të sotëm me kulturën. Kronologjia e mendimit shënon se për grekët kultura ishte një shenjë që dallonte botën e përbashkët, kolektive (*koinos kosmos*) nga bota private (*idios kosmos*) e zhvilluar falë përvojës dhe njohurive personale dhe që mbetet e veçantë dhe unike, autori vënë në veprim një lojë sarkastike fjalësh, duke e quajtur Ballkanin jo një *idios kosmos*, por një “botë idiotike”.

Duket sikur autori, ndonëse i njeh kufijtë e realitetit dhe të iluzionit, mëton afrimin me filozofinë utopike të Thomas More, ku qytetarët janë së përkushtuar ndaj lumturisë së të tjerëve po aq sa edhe për kënaqësisë së tyre, siç paraqitet në librin “Shqiptarët e mi dhe Mali i Zi i Jonë”. Por kur pjesë e asaj që ndodh në realitet bëhet edhe ky autor, ndjesitë përziehen, bëhen ambivalente, ku jo rrallë *Vetja* është *Tjetri* në gjendjen e tij të lirë apo i tjetërsuar.

Tjetri në veprën Shqiptarët dhe unë

Për shkak të multikulturalizmit *Tjetri* në Ballkan është i ndryshëm nga *Ne* për nga origjina, kombësia, besimi, ideologjia dhe përfaqësimi social, duke qenë gjithashtu *Tjetri* që t’u ndodh pranë. Ai shfaqet si “kërcënim për rendin dhe rregullimin e gjithë botës tuaj”, siç do të shprehej J.P. Sartre⁴, por njëkohësisht edhe shkaktar që ajo botë “përhumbet nga vlerave të të Tjerëve, mbi të cilat nuk keni kontroll”⁵.

Marrëdhënia e tillë e bën jo të lehtë formulimin e pyetjes “kush jam” dhe thujtjes të pamundur përgjigjen e drejtë se “kujt i përkas”, të cilat Jovan Nikolaidis i parashtron që në parathënien e librit “Shqiptarët dhe unë”⁶. Për të theksuar se identitetet e tij të shumëfishta janë pjesë e tij integrale, ai përdor metaforën e ujërave të detit, ujërat malazeze të të cilit vështirë se ndahen nga shqipja, italishtja dhe kroatishtja.

¹ Zygmunt Bauman: *Modernity and Ambivalence*. “Polity Press”. Cambridge, UK, 1993, fq. 73-101.

² Shih Jovan Nikolaidis, Monahos 6. Portali “Plima”, 2017.

³ Goran Starcević: *Groblje kao metafora zajedničkog svijeta*. <http://www.e-novine.com>. 17. Qershor 2016.

⁴ Jean Paul Sartre. *Being and Nothingness*. “Washington Square Press”, 1993.

⁵ Shih Paul Vincent Spade, Jean-Paul Sartre’s *Being and Nothingness*, 1996.

⁶ Jovan Nikolaidis, *Shqiptarët dhe unë*. “Koha”, Prishtinë, 2018.

Të shkruash për *Tjetrin*, që të rri përkrah, që të rri përbri dhe që të shfaqet përpara gjatë gjithë historisë, bëhet veprimtari po aq e rrezikshme, sa të marrësh përsipër të pajtosh fantazmat e së kaluarës dhe të sheshoh paragjykimet e shumta në Ballkan.

Nga ana tjetër, të shkruash jo përshtypje udhëtimesh, por një thurimë të plotë për *Tjetrin*, nuk është njëlloj si të shkruash një libër për *Veten* dhe për njerëzit me të cilët ndan të njëjën gjuhë, të njëjtat kujtime, të njëjtë paragjykime, të njëjtë stereotipe të të menduarit, të njëjtën histori dhe të njëjtën kulturë.

Kjo pasi duhet të dëshmosh jo vetëm se të prek fati që është treguar mizor ndaj *Tjetrit*-fqinj, si në rastin e Medeas - një e huaj në kontekstin e kulturës vendase - por edhe t'i kundërvihesh haptazi stereotipeve endemike ballkanase të cilat, pavarësisht kanë zënë vend dhe na duken normale jo ngase janë të vërteta, por ngaqë i kemi dëgjuar të përsëriten kudo dhe për një kohë të gjatë.

Pikërisht normaliteti i këtij auto-stereotipi që riprodhohet edhe përmes sistemit arsimor është më i tmerrshëm se të gjitha mizoritë së bashku, siç shkruan Hanna Arendt¹. Pikërisht këtë normalitet të ngritur mbi mitin e ushqyer me pragjykim përpiket ta demitizojë Jovan Nikolaidis përmes komunikimit të tij me lexuesin virtual të portalit Plima dhe në librin “Shqiptarët dhe unë”.

Të zgjedhësh këtë pozicion dhe të shkruash një libër si ky nuk duhet të jesh i frymëzuar, duhet të jesh i drejtë. Kjo pasi ky *Tjetër* nuk është i panjohuri diku. Me *Tjetrin* ke ndarë jo vetëm gjeografinë, por edhe historinë edhe heronjtë kulturorë të cilët, para se të ishin të tillë, kishin qenë grabitës, përdhosës dhe shkelës tabush që për njërin anë u heroizuan dhe për anën tjetër u demonizuan me kalimin e kohës². Nën këtë pikëvështrim *Tjetri*-fqinj përfshihet në garat për hegjemoni kulturore dhe për etninë e pastër ku heronjtë kulturorë përfshihen në katalogun e miteve të ricikluara.

Si shkrimtar Jovan Nikolaidis e ka kuptuar se mirësjellja intelektualiste nuk do të na lejojë të shprehemi pa fshehur gjë mbi ngjashmëritë dhe dallimet, mbi fajet, gabimet, mbi detyrat dhe veset, për kohërat kur ishim pranë dhe për vitet kur u ndamë dhe kur pusitë zunë vendin e dyluftimeve, siç vajet dhe gjamat zënë vendin e këngëve të dasmave, siç i ndeshim në këngë të ngjashme të Eposit *Tonë* dhe të *Tjetrit*.

Heteronimet si medium i vetvetes

Përpjekja për t'iu afruar temës së *Tjetrit* (shqiptari në këtë rast) ka bërë rrugë të gjatë me Jovan Nikolaidisin, i cili për t'iu qasur *Tjetrit* shfrytëzoi konceptin letrar të heteronomisë apo polinomisë.

Është i njohur fakti se në kontekstin e psikoanalizës, pas heteronimeve të përdorura vërehet kërkesa për t'u çliruar prej detyrimit që sjell me vete përkatësia. Te Jovan Nikolaidis kjo prirje mund të vështrohet edhe si kërkesë për shumëfishimin e formave të lirisë, që shkojnë përtej emrit dhe përfaqësimeve të tij, përtej domethënieve dhe kufizimeve të ciliësimit (malazez, i krishterë, etj).

Përveç emrit të njohur, tekstet e këtij autori i shfaqen lexuesit klasik dhe atij virtual herë si Joanis Arvaniti dhe herë si Sandro Galeb. Në emër të këtij të fundit shkruhen ditarët meditativë dhe kujtimet, përfshi edhe mendime mbi vetë Jovan Nikolaidisin, ndërkohë që me Joanis Arvanitis shkruhet prozë autofiksion.

Është e qartë se ky autor nuk përdor thjesht pseudonime letrare, por heretonime. Ai i përdor heretonimet e veta për të krijuar identiteve të pavarura edhe nga vetë ai. Përmes tyre ai zgjeron lirinë e të shprehurit, qoftë kur shkruan për të vetët, qoftë kur shkruan për tjetrin.

Në tekstin “Një përpjekje për autobiografi” narrativa e Jovan Nikolaidisittë krijon bindjen se bëhej fjalë për një individ krejt të ndryshëm nga Sandro Galeb. Ai e thekson faktin se e kaloi gjithë jetën në vijën e demarkacionit, mes dy horizonteve të ndryshme kulturore dhe shoqërore, mes konflikteve të vullshme, mes horizontit totalitar dhe horizontit globalist, mes komunizmit të vdekur dhe nihilizmit agresiv,

¹ Hannah Arendt, *Eichmann in Jerusalem: A Report on the Banality of Evil*, “Penguin Books”, London, 2006. Fq. 276-277.

² Shih: James G. Frazer. *Myths Of The Origin Of Fire*. “Barnes & Noble”, New York, 1996.

ndërkohë që heteronimi i tij Sandro Galeb paraqet një natyrë të dytë, më meditative, që i përket mendimit, jo aksionit.

Teksa merr në shqyrtim krijimtarinë e heteronimit tjetër Joanis Arvanitit studiuesja Jelena Knežević, vëren se romani “Naši su životi bjekstva” vjen si një projekcion dinjitoz dhe i gjallë i shqiptarëve dhe ihapësires malazeze, madje edhe më e gjerë, i hapësirës ballkanike në tërësi. “Përmes historisë familiare përftohet një roman metapoetik, ku bashkë me toponimet shqiptare të Korçës dhe Lumit Devoll shprehet edhe të kuptuarit e dashurisë sabbatike për *Të tjerët*,¹ thekson autorja e studimit, duke vëzhguar sesi autori plotëson identitetin real me një identitetin e ri mendor dhe stilistik të Joanis Arvanitis.

Me heteronimet Joanis Arvaniti apo Sandro Galeb, që Jovan Nikolaidis përdorur, ndihet dëshira e daljes prej një këmishës së forcës së një identiteti të vetëm. Përmes këtij pluraliteti identitetesh autori shndërrohet në një “medium të vetvetes”, siç e cilëson procesin Fernando Pessoa. Prej heteronimisë së shumëqëllim të këtij autori kuptohet gjithashtu edhe vullneti i braktisjes së paracaktimit etnik dhe kulturor.

Por a mund t’i kërkojmë gjurmët e transkomunikimit dhe të krijimit të identiteteve të tjerë virtualë te prirja e heteronimeve që përdor shkrimtari Jovan Nikolaidis? A përfaqëson kjo formë një mënyrë të tërthortë komunikimi apo edhe një mënyrë tjetër jetese në mendim, sikurse edhe forma të tjera ekzistence përmes shkrimit?

Heteronimi Sandro Galeb, për shembull, krijon një entitet me tipare të tjera, ku Sandro shfaqet si njeriu që jeton në një mjedisi multireligjöz. Megjithatë ai nuk është mbështetës i asnjë feje dhe besimi, por shkruan mendurshëm diskutime rreth kombit dhe identitetit.

Rasti Kierkegaard dhe Pessoa jep disa mënyra të gjera interpretimi lidhur me rolin dhe ndikimet stilistike dhe përfaqësimet kuptimore të autorëve që përdorin heteronime.² Por me ndarjen e identitetit letrar në personalitete të trefishtë shkrimtari Jovan Nikolaidis paraqitet si mjeshtër largimit dhe afrimit të Vetes nga Tjetri. Ai e krijon *Tjetrin* nga brenda *Vetes*, duke e tjetërsuar botën fizike në botë virtuale përmes heteronimisë.

Do të jetë e hapur udha për studiuesit, të cilët mund të hulumtojnë se çfarë ndodh me edhe me këtë autor kur shkruan jo vetëm për *Tjetrin* me emrin e tij dhe kur shkruan me njërin nga heteronimet. Si i zgjedh ai ato: në bazë të tematikës apo të stilit? Çfarë tiparesh dhe cilësish u ka dhënë atyre dhe a ruhen ato kur kalojnë nga libri në libër. A do të ishte e mundur që bashkë me ndryshimin e emrit të ndryshojë edhe identiteti i heteronimit? Çfarë mund të ndodhë, për shembull, nëse lexuesi malazez, serb apo kroat lexon të njëjtin tekst të nënshkruar me Joanis Arvaniti, Sandro Galeb dhe me Jovan Nikolaidis? A vërehen dallime të rrafshit stilistikor midis teksteve të shkruar me heteronimeve letrare, a shfaqen aty prani të personaliteteve të tjerë?

Është e dukshme se Jovan Nikolaidis nuk i krijon heteronimet vetëm e vetëm për t’u shprehur në stile të ndryshme, por për të shpikur një idiomë, për të hyrë nën lëkurën e Tjetrit dhe për të shprehur në vokacionin e tij, si një alter ego.

Prej këtej do të ishte me interes të vëzhgohej, për shembull, se çfarë ndodh me ndjesitë nacionaliste apo kozmopolite të autorit kur ai nënshkruan me Jovan Nikolaidis dhe kur nënshkruan Sandro Galeb apo me

¹ Shih artikullin *Drugom priči kao čovjeku*, të Jelena Knežević, botuar në poeralin Stav, më 8 qershor 2018. <http://www.stav.com.hr>.

² Lidhur me argumentin e rolit dhe ndikimet e heteronimeve në krijimtarinë e një autori shih *Kierkegaard's Influence on Literature, Criticism, and Art: The Anglophone World*; Jon Bartley Stewart ed. “Ashgate Publishing Limited”, England, 2013. Elisabete M. de Sousa and António M. Feijo: *Fernando Pessoa: poets and philosophers*; Ernesto Sábato: *The darker side of Kierkegaardian existence*. faqe 57-86

Joanis Arvaniti? Cili prej tyre shprehet më qartë dhe a mund të jenë ata i njëjti autor pas përdorimit të hereronimeve si formë e shumë personaliteteve në një të vetëm?

Forma të shfaqjes së Tjetrit në qytetërimet lokale

Jovan Nikolaidisdhe format eshumëllojshme të shfaqjes së teksteve të tij ndaj temave ballkanike dhe kureshtja për *Tjetrit* që rri pranë, e ka zanafillën me themelimin e së parës gazetë në gjuhën shqipe në Mal të Zi, me titullin “Kronika”. Por nëse do të zgjedhim një gur shenjtar, si të tillë mund të vendosim librin “Tespihet prej fosfori”, botuar në Tiranë gjatë vitit 2009.

Duke lexuar tekstet e këtij autori në harkun e 10-15 viteve të fundit, vëren se tek ai rri metafizika e “njeriu i revoltuar”, portretin e të cilit Albert Camus e ka përshkruar si histori të mendimit që shkon paralelisht me historinë e rebelimit.

Këto dy gjendje humane vihen në bashkëveprim jo vetëm kur përballen me padrejtësinë dhe zhgënjimin, por si akte rebeluese “që shprehin nostalgji për pafajësinë dhe bëjnë thirrje për thelbin e qenies”.¹Te Jovan Nikolaidis kjo ndjesi ngre krye kur i duket të tejkalojë mendësinë e të vetëve dhe të vetvetes, për ta kaluar të drejtën në anën e *Tjetrit*, madje të bëhet si *Ai*.

Me këtë krijimatri autori është njeriu që angazhohet dhe që nuk ndihet mirë kur mendjet e lira robërohen. Por, teksa lexon tekstet e Jovan Nikolaidisit në portalin “Plima”, te “Letrat e reja ulqinaqe”, te “Idetitetet tona”, botuar në vitin 2013, te “Tespihet...” dhe te libri më i fundit “Shqiptarët dhe unë”, të krijohet mendimi se ky autor ka poshtë lëkurës së tij hartën e Haemusit, Ballkanit Jugperëndimor apo Europës Juglindore, siç na pëlqen ta quajmë sot.

Në çdo kapitull të librave të tij rreth temës së *Tjetrit*, shprehet kërkesa për multikulturë, diversitet, për një shoqëri me pluralizëm kulturor, kulturë polilingvistike, siç ndihet edhe shpresa dhe zhgënjimi, por jo dorëheqja e dorëzimi, e cila jo rrallë ka lodhur idealistët e stoikët.

Në këto tekste lexuesi përplasat me njeriun që kërkon të vërtetën e thjeshtë dhe ka dëshirë për zgjerim të kuptimit të termit identitet dhe më shumë liri në komunikim. Dilemat e shfaura lidhen me dyshimin se ajo që po ndërtojmë i ngjan më shumë urave apo mureve, nëse po projektojmë të ardhmen apo po përtërijmë të kaluarën, duke iu rikthyer kompleksit të përuljes dhe i epërsisë në marrëdhënie me *Tjetrit*.

Këtë fakt nënvizon edhe kritiku Vladimir Vojonivić kur, duke u shprehur për librin “Valdanos” shkruan se gjuha dhe literatura malazeze dëshiron të mbivendoset ndaj vlerave të kulturave të tjera që zhvillohen në atë vend, ndërkohë që këtë ndjenjë superioriteti nuk e shfaqin edhe ndaj kulturave të tjera.²

Po ta lexosh krijimtarinë e Jovan Nikolaidisit si një vepër që plotësohet vazhdimisht, bëhet i qartë edhe ngulmimi i autorit për të na e sjellë *Tjetrit/shqiptar* jo vetëm më pranë, por sa më larg idealizimit.

Kjo prirje bëhet e dukshme sidomos kur *Tjetri/shqiptar* paraqitet i shoqëruar me historinë e tij, të cilën autori dëshmon se e njeh jo vetëm për sa i brendashkruhet territorit që përkufizohet si Shqipëri në kufijtë e sotëm gjeo-politikë, por edhe të një hapësire më të gjerë ku jetuan dhe jetojnë shqiptarë, në Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni e sidomos te arvanitasit dhe te arbëreshët e Italisë.

Duke ndjekur argumentet, faktet, shpjegimet, ëndrrat dhe makthet, dëshirat e mira, urimet dhe mospajtimet e hapura, që autori shpreh gjatë rrugëtimeve të tij në Shqipëri dhe Kosovë, duket se shkrimtari Jovan Nikolaidis shfaqet i zhveshur si prej *etnofilisë* ashtu edhe përballë *etnofobisë*. Ai vazhdon të pohojë atë që ka filluar të thuret që herët në Epos: pranimin e *Tjetrit* jo si armik, por si të barabartë e ndonjëherë edhe si më me shumë virtyte e cilësi, siç e gjejmë në disa verione në Epos.

¹ Albert Camus, *The Rebel*. “Penguin Random House”. London, 1993.

² Vladimir Vojonivić, *VALDINOS ili o religiji apsolutne sumnje*. Pogoricë, 2015

Autori i lëshon gjithmonë e më shumë vend konceptit se pozita më e këshillueshme ndaj *Tjetrit* nuk është armiqësia dhe konstatimi i armiqësisë, por përfillja e tij si i ndryshëm nga ti dhe i barabartë. Ky autor e shpreh qartë nevojën që ka shoqëria ballkanase ai për vetëidentifikim ashtu edhe për pranimin e Tjetrit, ndaj dhe vëzhgimet përqipen t'i shmangen me sa munden rimitizimit.

Në përfundimet e tij duket se shoqëria ballkanase nuk ka arritur ende t'i shfaqë pa inferioritet vlerat, edhe pse e di se është e qarkuar nga “qytetërime lokale” dhe globale, që kanë prirje të thesuara narcizmi.

Tjetri i Jovan Nikolaidisit i rri pranë përfytyrimit të *Tjetrit* të Ryszard Kapuscinski, të cilin e “takojmë përgjatë rrugës dhe nëpër botë në një mënyrë të dyfishtë: si “person si ne të tjerët”, me “gëzimet dhe pikëllimet e tij”, por edhe si një person të dytë, “i cili përputhet me të parin dhe që është bartës i karakteristikave racore dhe të një tjetër kulture besimi dhe bindjeje”.¹

Nga ana tjetër kontributi i këtij autori përmes botimit të artikujve në mediet sociale, të cilat i drejtohen lexuesit virtual e zgjeron komunikimin e tij, duke e bërë pjesë të një marrëdhënjeje më të gjerë që interesohet mbi jetën reale të tjetrit dhe përfytyrimin e *Tjetrit* në letërsi.

¹ Ryszard Kapuscinski. *Tjetri*. “Botimet Papirus”. Tiranë, 2018.